

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

INFOSOFT SYSTEMS

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J61820021C

NUIS/NIPT

Rruga Murat Toptani, Gjergji Center

Adresa

Tiranë

Albania

1010

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692070546

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

bagolli@infosoftgroup.com.al

E-mail

Administrator i Pergjithshem Armand Shara

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/03/07

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355692048484

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-96925-02-29-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

15000000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/03/25

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2024/03/25

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/41583/02292024

48444100-3

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij
VKM nr. 285, date 19.05.2021 Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik
Dokumentet Standarte te Tenderit
Vendime te Komisionit te Prokurimit Publik

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Ne date 01.03.2024 identifikuam te publikuar ne SPE te APP njoftimin e procedures se prokurimit nr. REF 96925-02-29-2024 me objekt prokurimi Unifikimi i sistemit të faturimit dhe mirëmbajtja për dy vjet , me fond limit 15 000 000(pesëmbëdhjetëmilion) pa TVSH publikuar nga Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarandë Sh. A.

Pasi u njohem me Dokumentet Standarte te Tenderit, evidentuam parregullsite dhe mangesite e meposhtme.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Kerkesa 1:

Ne Shtojcen 8 “Formular i Kriterëve të Perzgjedhjes/Kualifikimit”, kap. 2. “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.2 Autoriteti kontraktor ka publikuar kriterin si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit D.P.A., ose organizma nderkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a. ISO 9001: 2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë)
- b. ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit)
- c. ISO 20000 (manaxhimi i shërbimeve IT),
- d. ISO 13008 (për Konvertimin dhe Migrimin e të Dhënave)

Në pikën d. keni kërkuar certifikatën ISO 13008 për “Konvertimin dhe migrimin e të dhënave të leshuar nga organizmat e vleresimit të konformitetit të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit D.P.A., ose organizma nderkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Deri në datën e formulimit të kësaj ankese dhe për rrjedhim deri në datën e publikimit të Njoftimit të Kontratës referencë REF 96925-02-29-2024, kjo certifikatë ende nuk është njohur dhe akredituar zyrtarisht nga organizmat nderkombëtare, konkretisht ISO, që merren me këto certifikime.

Në linkun e mëposhtëm do të gjeni informacionin e duhur, dhënë edhe nëpërmjet fotos (screenshot)

që gjendet në këtë link <https://www.iso.org/standard/75569.html>.

Procesi i njohjes dhe akreditimit të kësaj certifikate, sipas të dhënave të vetë organizmit ISO, është duke ndjekur ciklin e nevojshëm dhe aktualisht ndodhet në hapin 60.60 (publikimi), si në figurën më sipër. Deri në jetezimin dhe certifikimin për përdorim të saj, kjo certifikatë duhet të përfundojë ciklin e plotë sipas standarteve të organizmit certifikues ISO.

Të kërkohej interpretim nga DPA, nëse është një standard i akreditueshem ose jo.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës për pajisjen e operatorit ekonomik me certifikatën ISO 13008.

Kerkesa 2:

Ne Shtojcen 8 "Formular i Krihereve to Perzgjedhjes/Kualifikimit", kap. 2. "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", ne piken 2.3.3 Autoriteti kontraktor ka publikuar kriterin si me poshte:

2.3.3 Per te vertetuar qe ka kapacitete njerezore, profesionale te mjaftueshme per realizimin ne kohe dhe sipas specifikimeve teknike te projektit, operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 9 (nente) punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve dhe formulareve E-SIG per periudhen e 3(tre) muajve te fundit duke iu referuar dates se shpalljes se procedures ku OE duhet te kete te punesuar punonjesit si vijon:

- a. Te pakten 4 (kater) programues/zhvillues software ku 3 (tre) prej tyre te jene te certifikuar ne implementim ose zhvillim te zgjidhjes softwerike se ofruar ose te teknologjive nga te cilat perbehet zgjidhja softwerike ne nivel ekspert dhe 1 (nje) te jete ?ertifikuuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar.
- e. Te pakten 1 (nje) person të ?ertifikuuar në nivel profesionist ne implementimin e web sherbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.
- f. Te pakten 1 (nje) analist biznesi te certifikuar ne nivel specialist.

Ne procesverbalin e argumentimeve jane argumentuar si me poshte keto kerkesa, por Autoriteti Kontraktor nuk ka dhene sqarime per nivelet e kerkuara te certifikimeve si "ekspert", "profesionist" apo "specialist".

Argumentimi: Ne baze te nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr.162 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Procesi i fiskalizimit te faturave lidhet ngushte me mbarevatjen funksionale, financiare dhe integritetin profesional te Autoriteti Kontraktor i cili ne rast vonesash dhe/ose problemesh, sa do ne dukje te vogla qofshin, shkaktojne deme ne besimin e klienteve tek ky i fundit, pra bazuar ne pervojen e gjate te AK-se per shmangjen e cenueshmerise te integritetit te tij jane kerkuar qe OE te disponoje staf te specializuar si me poshte:

- a. Kriteri per disponimin e 4 (kater) programues/zhvillues software ku 3 (tre) prej tyre te jene te certifikuar ne implementim ose zhvillim te zgjidhjes softwerike se ofruar ose te teknologjive nga te cilat perbehet zgjidhja softwerike ne nivel ekspert dhe 1 (nje) te jete ?ertifikuuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike e ofruar, garanton AK per aftesite profesionale te punonjesve qe ka OE. Disponimi i 3 (tre) programues/zhvillues software te certifikuar garanton per implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjate gjithë afatit te dhe fazave te kontrates dhe gjithashtu garantoje implementimin e te gjithë specifikimeve te kerkuara nga AK. Gjithashtu keta specialiste garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithë periudhes se kontrates. Disponimi i 1 (nje) programues/zhvillues software ?ertifikuuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave qe perdor zgjidhja softwerike vjen si nevoje per te garantuar mirembatjen, optimizimin, nderhyrje te pergjiegjshme ne bazen e te dhenave si dhe per te garantuar performance maksimale gjate gjithë shitrirjes se kontrates pavaresisht shtimit te sasise se te dhenave ne te, ashtu sic dhe eshte cituar ne specifikimet teknike.
- b. Kriteri per disponimin e te pakten 1 (nje) të ?ertifikuuar në nivel profesionist ne implementimin e web sherbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent vjen si nevoje vjen per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme, me institucionet financiare banke dhe jo banke te cilat kane sisteme te cilat integrohen per te rakorduar automatikisht detyrimet dhe pagesat lidhur meabonentet, me programin e fiskalizimit, integrimet keto qe perdorin protokolle standarte Soap, Rest ose ekuivalente sic eshte cituar dhe ne specifikimet teknike.
- c. Kriteri per disponimin e te pakten 1(nje) analist biznesi te certifikuar ne nivel specialist vjen si nevoje per te siguruar saktesine e nevojshme ne analizimin e kerkesave te perdoruesve ne

menyre qe te behet i mundur konfigurimi i duhur i zgjidhjes se ofruar. Analisti i biznesit do te ndihmoje ne analizen e kerkesave per te gjitha sherbimet qe duhet te realizohen nga operatori ekonomik ne niseje te kontrates. Edhe gjate fazes se mirembajtjes, nevojitet te pakten një analist biznesi qe te kete njohurite e duhura dhe te deshmuara ne procesin e analizes se kerkesave qe mund te vijne nga perdoruesit e SHRUKS edhe gjate fazes se mirembajtjes.

Autoriteti Kontraktor nuk ka argumentuar se perse kerkohet nje nivel i caktuar i certifikimit. Nese i referohemi argumentimit per certifikimet e kriterit 2.3.3 pika a) kerkohet certifikimi ne nivelin “ekspert” dhe me pas argumentohet qe “?keta specialiste” garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithë periudhes se kontrates.”

Pra, ne kete pike e kemi te paqarte nese kerkohet niveli ”Ekspert” apo ”Specialist”, sepse vete argumentimi i AK parashikon qe specialistet garantojne vijueshmerine normale te punes.

Ne vijim te arsyetimit dhe bazes ligjore te sipercituar, kerkesa e Autoritetit nuk percakton se per cfare arsyeje nevojitet certifikimi ne nivelin specifik te kerkuar, kur ka shume certifikime qe deshmojne fitimin/zoterimin e njohurive teknike per sherbimet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Eshte detyrim ligjor i Autoritetit Kontraktor te percaktoje ne menyre te drejte, te qarte dhe te kuptueshme kriteret e kualifikimit, te formuloje saktesisht kerkesat e publikuara, si dhe te parashikojte ne menyre ezauruese te gjithë dokumentat konkrete qe duhet te dorezojne Operoret Ekonomik ne tender, ne menyre qe te garantohet mundesia e konkurrences efektive per operoret pjesemarres ne tender.

Kriteri kualifikues nuk permban asnje reference dhe/ose percaktim per klasifikimin e niveleve te certifikimeve qe duhen mbajtur parasysh nga Operatori Ekonomik gjate permbushjes se kriterit. Operoret nuk kane nje reference mbi te cilen te mbeshteten per te permbushur kete kerkese (nivel certifikimi): a eshte ky klasifikim i certifikatave te prodhuesve; i prodhuesit te produktit/sherbimit te ofertuar; institucioneve certifikuese te akredituara ose jo ne Republiken e Shqiperise apo institucioneve jo qeveritare dhe/ose arsimore nderkombetare.

Neni 40 i VKM per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik parashikon:

“3. Kerkesat e veçanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve.”

Ne keto kushte qartesia dhe kuptueshmeria e dokumentave te tenderit eshte detyrim kryesor ligjor qe duhet te permbushet nga Autoriteti Kontraktor dhe kerkesat e DST nuk duhet te permbajne elemente te panevojshem qe pengojne OE te marrin pjese ne procedura prokurimi, Per sa me siper, kerkojme heqjen e termave nivel eksperti , “nivel profesionist” dhe nivel specialist”.

Kerkesa 3:

Ne dokumentin “Specifikimet teknike” ne Tabelen e Çmimeve te Sherbimeve, afati i levrimit per konfigurimin e zgjidhjes softwerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA, si dhe permbushja e te gjithë funksionaliteteve te specifikuara ne paragrafet e tjere te ketij dokumenti, kerkohen te realizohen per nje periudhe 10 ditore.

Realizimi i te gjithë ketyre kerkesave, duke i pershtatur me nevojat e klientit konsiderohet i pamundur per nje periudhe kaq te shkurter kohe.

Per sa me siper kerkojme zgjatjen e ketij afati dhe caktimin e nje periudhe 6 mujore implementimi e cila do te perfshije analizen e kerkesave te klientit si dhe pershtatjen e funksionaliteteve te zgjidhjes se gatshme per t'i sherbyer sa me mire nevojave te institucionit.

Nisur nga eksperiencia jone shumevjecare ne ofrimin e sherbimeve te implementimit te softuerit te njejte me objektin e kesaj procedure prokurimi, levrimi per konfigurimin e zgjidhjes softwerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA eshte realizuar mesatarisht brenda nje afati 6 mujor, ne te cilin eshte perfshire: faza e mbledhjes se kerkesave te klientit, analizimi i tyre, evidentimi i parametrizimeve ne sistem dhe implementimi i tyre, dokumentimi i implementimit te kryer, testimi etj, duke angazhuar resurset me te kualifikuar te kompanise. Ne keto kushte, per te permbushur me cilesi dhe efikasitet kerkesat e AK per sherbimin e kerkuar eshte e domosdoshme zgjatja e afatit te realizimit te ketij sherbimi.

Kerkesa 4:

Ne dokumentin “Specifikimet teknike” ne Tabelen e Çmimeve te Sherbimeve, afati i levrimin per pajisjet mobile dore PDA eshte 10 dite.

Nr.	Emertimi	Sasia	Çmimi	Vlera	Afat levrimi
1	Blerje, aktivizim dhe konfigurim i zgjidhjes softwerike ne Cloud, Lexim, Faturim, Fiskalizim, Arketim dhe App mobile per PDA per nje periudhe 2 vjecare	1			10 dite
2	Migrim i te dhenave	1			1 muaj
3	Integrim me pale te treta nepermjet sherbimeve Web Service	1			10 dite
4	Mirembajtje e zgjidhjes softwerike per nje periudhe 2 vjecare	1			24 muaj
5	Pajisje mobile dore (PDA)			20	10 dite

Per shkak te eksperiencas qe ne kemi ne tregtimin e ketyre produkteve, si dhe nga informacioni qe zoterojme per shkak te studimit te tregut shqiptar, Pajisje mobile dore (PDA) eshte thuar se pamundur te gjenden ne tregun shqiptar dhe duhen porositur ne furniture nderkombetar. Per kete arsye, ne menyre qe OE te kene mundesi te barabarta ofertimi, kerkohet nje afat me i gjate per levrimin e ketyre pajisjeve.

Gjithashtu, duke qene se levrimi i Pajisjeve mobile dore (PDA) per nje afat me te gjate nuk pengon punen e Autoritetit Kontraktor, pasi qe ato te jene te perdorshme duhet te kete perfunduar paraprakisht implementimi i sistemit por edhe migrimi i te dhenave.

Si arsyetuar me siper, kerkojme zgjatjen e afatit te levrimin te per zerin 5 “Pajisje mobile dore (PDA)”, dhe konkretisht afati i levrimin te tyre te behet per nje periduhe jo me te vogel se 2 muaj.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

N/A

7. Lista e informacionit konfidencial:

N/A

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

bagolli@infosoftgroup.com.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Armand Shara